

VENDIM
Nr. 546, datë 19.9.2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 72, DATË 7.2.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE BAZË TË SEKTORËVE QË DO TË MBËSHTETEN DHE TË MASËS SË FINANCIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL, PËR VITIN 2018”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 6, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 72, datë 7.2.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

Në nënndarjen “iii”, të shkronjës “c”, të nënpikës 2.1, hiqen fjalët “... sipas specifikimeve të shkronjës “b”, të nënpikës 2.1 ...”.

2. Në shkronjën “a”, të nënpikës 2.2, pas fjalëve “... për krerë të lindur ...” shtohen “... dhe tufën bazë ...”.

3. Pas nënpikës 2.7 shtohet nënpika 2.8, me këtë përmbajtje:

“2.8. Përfituesve të financimit nga masat e mbështetjes të përcaktuara në shkronjat “b” e “ç”, të nënpikës 2.1, në nënndarjet “i”, “ii”, “iii”, “iv” dhe “v”, të nënpikës 2.2, në shkronjën “b”, të nënpikës 2.4, dhe në nënpikën 2.7, pas lidhjes së kontratës u paguhet paraprakisht 30% e masës së financimit të kontraktuar, kundrejt garancisë së parapagesës, të lëshuar nga shoqëri sigurimi dhe/ose banka, si dhe situacione pjesore të punimeve të kryera dhe/ose blerje të makinerive dhe pajisjeve, të vërtetuara kundrejt dokume-ntacionit përkatës.”.

II. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama